

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SMARTSHROOM GLOBAL” SH.P.K

Në Tiranë më datë 28.10.2025, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, themelohet Shoqëria Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar **“SmartShroom Global” sh.p.k** me ortakë bashkëthemelues:

1. **Znj. Flonja Mersini**, e bija e Fatmirit, datëlindja 21.04.1979, lindur në Tiranë, banuese në Tiranë Kompleksi Delijorgji, me numër personal identifikimi H95421158S, shtetësia Shqiptare
2. **Znj. Rezarta Mersini**, e bija e Fatmirit, datëlindja 02.08.1983, lindur në Tiranë, banuese në Tiranë Kompleksi Delijorgji, me numër personal identifikimi I35802088C, shtetësia Shqiptare

SELIA

Selia e shoqërisë **“SmartShroom Global” sh.p.k** është vendosur në: Rruga Artan Lenja, Godina nr.33, 80 metra larg Kompleksit Kontakt, Tiranë. Shoqëria mund të hapë filiale brenda dhe jashtë vendit.

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë tregtare është pa afat duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria ka për objekt të ushtrisë aktivitetet me objekt si më poshtë:

Kultivimi, përpunimi dhe tregtimi i kërpudhave të freskëta dhe të thata; Zhvillimi i fermave moderne për rritjen e kërpudhave me teknologji “smart” dhe metoda bashkëkohore bujqësore; Ndërtimi dhe administrimi i tuneleve të kultivimit të kërpudhave dhe sistemeve të kontrolluara të klimës; Importi dhe eksporti i kërpudhave, farërave (sporeve), lëndëve të para, pajisjeve, dhe materialeve të nevojshme për kultivim; Tregtia me shumicë dhe pakicë e produkteve bujqësore



dhe ushqimore brenda dhe jashtë vendit; Shërbime konsulence, studime dhe trajnime në fushën e agroteknologjisë dhe kultivimit të kërpudhave; Marrëveshje bashkëpunimi me persona fizikë ose juridikë vendas e të huaj, për qëllime tregtare, teknologjike dhe logjistike; Kryerja e çdo veprimtarie tjetër tregtare që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, që ka rëndësi të drejtpërdrejtë ose tërthorazi për arritjen e objektivave të shoqërisë. Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe të huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **10.000 lekë**, i ndarë në **2 kuota**, të nënshkruara, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar është kontribuar si vijon:

- **Znj.Flonja Mersini** zotëron 60% të kapitalit
- **Znj.Rezarta Mersini** zotëron 40% të kapitalit.

ORGANET DREJTUESE

Organet Drejtuese të Shoqërisë “**SmartShroom Global**” sh.p.k janë **Asambleja e Ortakëve** dhe **Administratori**.

ADMINISTRATORI

Shoqëria “**SmartShroom Global**” sh.p.k do të administrohet nga **Znj. Rezarta Mersini**, me numër personal identifikimi I35802088C, banuese në Tiranë Kompleksi Delijorgji, për një **afat të pacaktuar**.

Administratori do të ketë të drejtë përfaqësimi të plotë të shoqërisë përpara të tretëve dhe autoriteteve publike dhe private.

NDARJA E FITIMEVE

Fitimet neto të shoqërisë që rezultojnë nga bilanci, me Vendim të Asamblesë së Ortakëve ndahen në përpjestim sipas kontributit përkatës të Ortakëve, pasi të zbriten shumat që u përkasin detyrimeve ligjore, fondit rezervë dhe të tjera të përcaktuara me ligj ose statut.



MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis Ortakëve gjatë zbatimit të Aktit të Themelimit, ose midis Shoqërisë dhe Ortakëve gjatë aktivitetit të shoqërisë, duhet të zgjidhen me mirëkuptim ose nëpërmjet ndërmjetësimit. Në të kundërt Palët i drejtohen Gjykatës kompetente.

TË TJERA

Dispozita më të hollësishme për mënyrën e funksionimit të shoqërisë, përshkruhen në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi hartuar në pesë kopje të barazvlefshme, pasi u lexua u nënshkrua nga palët më poshtë:

Ortakët e Shoqërisë

“SmartShroom Global” sh.p.k

Znj. Flonja Mersini



Znj. Rezarta Mersini

